



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.924 Prot.

Tiranë, më 07 .\_08. 2023

**V E N D I M**

**Nr.157 , Datë 07. \_08. 2023**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>2</sup>, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 176 Regj, datë 15.11.2022, paraqitur nga ankuesja J.G kundër Këshillit të Ministrave dhe Universitetit “Fan S.Noli” Korçë, me pretendimin për diskriminim për shkak të racës dhe vendbanimit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja J.G, deklaron se është banore e Njesisë Administrative Moravë, Bashkia Korçë. Ajo ka filluar studimet e larta në degën gjuhë-letërsi. Ajo deklaron se i përket komunitetit egjiptian dhe në bazë të Vendimit nr.269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave është përjashtuar nga tarifa e shkollës. Ankuesja informon se jeton në një zonë që është njësi administrative e Korcës dhe është në një largësi më tepër se 5 km nga universiteti që ajo ndjek. Në këto kushte ajo është e detyruar që çdo mëngjes të marrë një taksë për të shkuar në shkollë dhe gjendja e saj ekonomike është tepër e vështirë.

Ankuesja informon se, ajo jeton e vetme me nënën e saj, pasi babai e ka braktisur që kur ka qenë e vogël. Nëna e saj është e sëmurë dhe për shumë vite është trajtuar me KEMP, por ka afërsisht 1 vit që i është ndërprerë. Ky vendim është ankimuar por nuk ka marrë ende asnjë përgjigje.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Pranë fakultetit ku studion ankuesja ka parë që ka dalë njoftimi për përfitimin e bursës për disa kategori, sipas VKM nr.903 datë 21.12.2016. Pasi është paraqitur në sekretarinë e universitetit, i është komunikuar se ajo nuk mund të përfitojë bursë sepse nuk plotëson asnjë nga kriteret e përcaktuara.

Ankuesja shprehet se, në dijeninë e saj ka një VKM për mbështetjen e të gjithë nxënësve që ndjekin shkollën e mesme dhe që jetojnë 5 km larg nga shkolla, por një mbështetje e tillë nuk zbatohet edhe për shkollën e lartë.

Ankuesja deklaron se, nuk ka asnjë mbështetje në kushtet në të cilat ndodhet, duke jetuar e vetme me nënën e saj, pa të ardhura dhe që i përket komunitetit egjiptian.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri, marrjen e masave për të përfshirë në VKM nr.903, datë 21.12.2016 edhe anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian. VKM nr.269, datë 29.3.2017 dhe VKM nr.903, datë 21.12.2016 kanë të përfshira të njëjtat kategori, por te VKM nr.903, datë 21.12.2016, nuk është përfshirë komunitetit rom dhe egjiptian. Ankuesja kërkon gjithashtu që në VKM nr.903, datë 21.12.2016, të përfshihen edhe studentët që jetojnë 5 km larg universitetit.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtpërdrejtë nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga ankuesja, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 7871/1 prot., datë 15.12.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Këshilli i Ministrave (KM) dhe Universiteti “Fan S. Noli” Korçë (Universiteti), në cilësinë e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa, si dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), e cila është ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit.

1.1 Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr. 7871/1 prot., datë 15.12.2022, MAS, ktheu përgjigje duke parashtruar:

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, shteti garanton të drejtën për arsimim për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë financiare për t’i përballuar ato. KM, është institucioni i autorizuar nga ligji për të nxjerrë akte nënligjore për përcaktimin e kategorive të individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë. Në zbatim të përcaktimeve të këtij neni, është miratuar vendimi nr.269, datë 29.03.2017 “*Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit*”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim mbështetjen financiare të kategorive të caktuara të studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, nëpërmjet përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve me rezultate të larta dhe studentëve që u përkasin shtresave sociale në nevojë. Sipas vendimit nr.269/2017, të ndryshuar, studentët romë dhe egjiptianë, të cilët identifikohen përmes vetëdeklarimit, janë parashikuar si kategori e veçantë që përfitojnë përjashtimin nga tarifa, pavarësisht plotësisht të kriterit të notës mesatare apo pamundësisë ekonomike.

Vendimi nr.903, datë 21.12.2016 i KM “*Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë*”, i ndryshuar, ka si qëllim përcaktimin e kritereve për kategoritë e studentëve që do të përfitojnë bursë nga fondi i mbështetjes studentore, në mbështetje të nenit 112, të ligjit nr.80/2015. Synimi i masave të përcaktuara në VKM nr.903/2016, të ndryshuar është të mbështesë me bursë studentët me rezultate të larta, studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare, studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton, studentët, të tretët në radhën e fëmijëve më lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më

shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë, studentët që kanë fituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç, studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç, studentët që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç dhe studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

Në lidhje me kriterin ekonomik VKM-ja nr.903/2016, e ndryshuar, referon te legjislacioni i posaçëm për asistencën sociale, duke përcaktuar si kategori përfituese, studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike. Në kushtet kur sipas kërkesës tuaj, citohet se znj. J.Gështë në gjendje ekonomike të vështirë dhe ka aplikuar për ndihmë ekonomike, sqarojmë se në këtë rast, përfitimi nga VKM nr.903/2016, i ndryshuar, kushtëzohet nga vendimi i organit kompetent në lidhje me përfitimin e ndihmës ekonomike. Për sa më sipër, nuk jemi përpara diskriminimit për shkak të racës, sepse studentët romë dhe egjiptianë mund të jenë përfitues sipas VKM nr.903/2016, të ndryshuar, në kushtet kur plotësojnë kriteret e përcaktuara, që lidhen me pamundësinë ekonomike për ndjekjen e studimeve apo rezultatet e larta (notën mesatare nga 9 deri në 10).

Në lidhje me aktin/aktet përkatëse për trajtimin dhe mbështetjen e nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucione 5 km nga vendbanimi i tyre i përhershëm, sqarojmë se:

Sipas vendimit nr.666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konviktet dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike*”, dalë në zbatim të nenit 19, të ligjit nr.69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, parashikohet se, një ndër kategoritë që përfitojnë mbështetje janë edhe nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike. Synimi i këtij parashikimi është mbështetja e nxënësve në pamundësi ekonomike që ndjekin procesin mësimor 5 km nga vendbanimi i tyre i përhershëm.

Sipas VKM nr.682, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*”, të ndryshuar, për arsimin e mesëm të lartë, përballohen nga fondet publike shpenzime transporti për kategoritë e mëposhtme:

- Nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara, që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik;
- Nxënësve që ndjekin procesin mësimor në institucionet arsimore publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, godinat e të cilave kanë dalë jashtë funksionit apo janë në

rikonstruksion/rindërtim, vërtetuar me aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe që udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor, larg vendbanimit të përhershëm.

Në arsimin e lartë, studentët nuk përfitojnë mbështetje bazuar në kritere që lidhen me vendbanimin, por bazuar në kritere të tjera që lidhen me notën mesatare, ndjekjen e një programi studimi që një nga fushat prioritare ose pamundësi ekonomike.

Sipas ligjit nr.80/2015, studentët në bazë të meritës kanë të drejtën të zgjedhin institucionin e arsimit të lartë ku duan të ndjekin studimet, duke u kushtëzuar nga kriteret e pranimit në programet përkatëse pavarësisht nga vendbanimi i tyre, ndërsa regjistrimet në arsimin parauniversitar kryhen bazuar në vendbanimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit. Bazuar në vendimin nr.903/2016, të ndryshuar, studentët nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara përfitojnë bursë pavarësisht largësisë së IAL-së nga vendbanimi i përhershëm.

Për sa më sipër, duke mbajtur parasysh ndryshimet mes sistemit arsimor parauniversitar dhe arsimit të lartë, nuk mund të bëhet paralelizëm në lidhje me formën e mbështetjes financiare nga shteti për nxënësit dhe studentët.

1.2 Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr. 2011/1 prot datë 06.12.2022, Universiteti, ktheu përgjigje duke parashtruar:

Pas verifikimeve të kryera nga ana jonë rezulton se, J.G ka aplikuar për përjashtim nga tarifat vjetore e studimit. Aplikimi në fjalë, së bashku me dakomentacionin shoqërues për përjashtim nga tarifa vjetore e studimit do të shqyrtohen dhe nëse rezultojnë në përputhje me VKM nr.269, datë 29.3.2017, i ndryshuar, znj. J.G, do të përjashtohet nga tarifa vjetore e studimit. Në lidhje me trajtimin me bursë studentore, ju informojmë se, znj. G do të trajtohet me bursë nëse plotëson kriteret e përcaktuara në VKM nr.903, datë 21.12.2016, i ndryshuar.

2. Me *e-mail* datë 06.01.2023, ankueses iu komunikuan përgjigjet e dërguara nga MAS dhe Universiteti. Ankuesja nuk depozitoi parashtrime në lidhje me qëndrimet e MAS dhe Universitetit.

3. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr.262 prot datë 14.02.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 28.02.2023.

Seanca dëgjimore e datës 28.2.2023, u zhvillua në mungesë të palës ankuese, e cila pavarësisht se kishte rregullisht dijeni për datën dhe orën e seancës dëgjimore, nuk paraqiti asnjë arsye për mospjesmarrjen në seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesmarrjen e përfaqësuesit nga Kryeministria, z. A.Ç, jurist, Zyra e Menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm dhe përfaqësueses së MAS, znj. I.N, specialiste në Sektorin e Çështjeve Juridike Administrative.

4. Me shkresën nr.389 prot datë 13.03.2023, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë për informacion Bashkisë Korçë, në lidhje me statusin e trajtimit të nënës së ankueses nga skema e

ndihmës ekonomike dhe asaj të aftësisë së kufizuar. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Korçë me shkresën nr. 2135/1 prot datë 29.3.2023, informoi Komisionerin, se:

Bazuar në të dhënat e Zyrës së Gjendjes Civile Drenovë, familja e znj. F. M, është banore e fshatit Moravë, Njësia Administrative Drenovë, në Bashkinë Korçë. Znj. M, ka kryer aplikimin në sistemin e ndihmës ekonomike në datën 07.10.2022, në fund të muajit tetor 2022 dhe bazuar në përgjigjen e sistemit të pikëzimit ajo rezultoi jo fituese. Në muajt nëntor e dhjetor 2022, për shkak se znj. M doli jo fituese në sistemin e ndihmës ekonomike, është trajtuar me ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor. Në muajin janar e shkurt 2023, znj. M kaloi për trajtim me ndihmë ekonomike nga 6% i fondit të kushtëzuar, ku vazhdon të trajtohet. Znj. M është trajtuar me prioritet në trajtimin me ndihmë ekonomike krahasuar me familjet e tjera që rezultojnë jo fituese në sistemin e pikëzimit. Në lidhje me pagesën e aftësisë së kufizuar, Bashkia Korçë informon se, znj. M është orientuar për plotësimin e dokumentacionit dhe dorëzimin e tyre pranë Komisionit Bio-psiko-social.

5. Bazuar në informacionin e administruar nga Bashkia Korçë se, nëna e ankueses prej janarit 2023 trajtohej me ndihmë ekonomike, me shkresën nr.389/2 prot datë 05.04.2023, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë për informacion Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë në lidhje me faktin nëse, ankuesja, në këto kushte, ishte përfituese e bursës studentore sipas VKM nr.903/2016, i ndryshuar, si studente në nevojë, pasi familja e saj trajtohet me ndihmë ekonomike. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr.301/3 datë 11.04.2023, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, informoi Komisionerin se:

Znj. J.G, trajtohet me bursë si studente në nevojë, bazuar në paragrafin 5, pika “a”, të VKM Nr.903, datë 21.12.2016 *“Për përcaktimin e kriterëve të përfitimit të bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”*, i ndryshuar.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

##### *Rrethanat dhe faktet.*

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja J.G, është e datëlindjes 23.04.2004, është banore e fshatit Moravë, Njësia Administrative Drenovë, Bashkia Korçë. Në bazë të akteve të lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Njesisë Administrative Drenovë, në Bashkinë Korçë, rezulton se ankuesja jeton vetëm me nënën e saj shtetasen F. M. Në bazë të deklaratës noteriale nr.2782 rep dhe nr.1264 kol datë 08.11.2022,

hartuar para noteres Brunilda J.Demiri, Anëtare e Dhomës Vendore të Noterëve, Korçë, ankuesja vetëdeklaroi se i përket komunitetit egjiptian.

Referuar informacionit të përcjellë nga Bashkia Korçë, nëna e ankueses është trajtuar gjatë periudhës 29.01.2018 – 31.12.2021 me pension invaliditeti. Pas kësaj periudhe, kërkesa e nënës së ankueses për t'u trajtuar sipas ligjit nr.7703, datë 01.05.1993, i ndryshuar është refuzuar dhe dosja është mbyllur me vendim nga komisioni përkatës epror. Në datën 07.10.2022, nëna e ankueses ka bërë aplikimin pranë Bashkisë Korçë për t'u trajtuar me ndihmë ekonomike dhe në fund të po këtij muaji sistemi i pikëzimit e ka vlerësuar se ajo nuk mund të jetë përfituese e ndihmës ekonomike.

Në vitin akademik 2022-2023, ankuesja ka filluar studimet Bachelor në Degën Gjuhë –Letërsi, pranë Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë. Në bazë të VKM nr.269, datë 29.03.2017, të ndryshuar rezulton se, ankuesja është përjashtuar nga tarifat vjetore të shkollimit, si studente që i përket pakicës kombëtare egjiptiane. Ankuesja parashtron në ankesën e saj se, kur është paraqitur në sekretarinë e universitetit për të aplikuar për bursë në bazë të VKM nr.903, datë 21.12.2016, të ndryshuar, i është thënë që nuk mund të përfitojë bursë, pasi nuk plotëson kriteret sipas kësaj VKM-je.

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 176, datë 5.11.2022, duke pretenduar se: 1) është diskriminuar për shkak të racës, pasi VKM nr.903, datë 21.12.2016, e ndryshuar nuk përfshin në kategorinë e studentëve që përfitojnë bursë, studentët që i përketin komunitetit egjiptian dhe atij rom, krahasimisht me VKM nr.269, datë 29.03.2017, të ndryshuar, e cila përjashtoi nga tarifat vjetore të shkollimit të njëjtat kategori, ku përfshihen edhe studentët egjiptianë dhe studentët romë; 2) është diskriminuar për shkak të vendbanimit, pasi për shkak të pamundësisë ekonomike në të cilën ndodhet familja e saj dhe distancës së vendbanimit nga universiteti që ajo ndjek, e ka të pamundur që të përballojë shpenzimet e transportit për ndjekjen e universitetit.

Gjatë kohës që ankesa ishte në shqyrtim, sipas informacionit të administruar, rezultoi se, nga muaji janar 2023, e në vijim, nëna e ankueses, ishte shpallur përfituese e ndihmës ekonomike nga 6 % i fondit të kushtëzuar, nga ana e Bashkisë Korçë, dhe në bazë të informacionit të vendosur në dispozicion nga Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë rezulton se, ankuesja trajtohet me bursë sipas VKM nr.903/2016, të ndryshuar, si studente në nevojë, që vjen nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, sipas shkronjës “a”, të pikës 5, të kësaj VKM.

*Analiza ligjore e fakteve dhe provave.*

Neni 18, i Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e parazisë dhe mosdiskriminimit, sanksionon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlikje e arsyeshme dhe objektive”.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021). Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14, i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore<sup>3</sup> (KEDNJ), nuk jep një përkufizim se çfarë përbën diskriminim. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “*dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme*” dhe “*bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm*”<sup>4</sup>. Gjithashtu, edhe pse nuk ka një përkufizim për diskriminimin e tërthortë, sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>5</sup>. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme<sup>6</sup>. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë

<sup>3</sup> KEDNJ, është ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, datë 12 gusht 1996.

<sup>4</sup> Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

<sup>5</sup> Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC]*, nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

<sup>6</sup>Shih: *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.



nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14<sup>7</sup>. Në rrethana të caktuara, neni 14 mund të nënkuptojë “*detyrime pozitive*” për shtetet për të parandaluar, ndaluar ose dënuar diskriminimin (Pla dhe Puncernau kundër Andorrës, 2004, prg. 62). Detyrime të tilla pozitive që kanë shtetet mund të përfshijnë të ashtuquajturat “*masa pozitive*” (Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, 2013, prg. 104) ose “*diskriminim i kundër/ i anasjelltët*”<sup>8</sup> ose “*veprim pozitiv*” që një shtet mund ose duhet të miratojë për të korigjuar “*pabarazitë faktike*”.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se, jo të gjitha dallimet në trajtim të personave në situata të ngjashme – ose dështimi për të trajtuar ndryshe personat në situata të ndryshme – përbëjnë diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë “*një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm*”. Sipas Gjykatës, trajtimi i diferencuar është diskriminues, nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>9</sup>.

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetues. Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet: “*“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”. LMD jep shprehimisht përkufizimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, në nenin 3, pika 2, sipas përmbajtjes vijuese: “*2. “Diskriminim i drejtëpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.*”, ndërsa përkufizon diskriminimin e tërthortë, në nenin 3, pika 7, sipas përmbajtjes vijuese: “*7. “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht*

<sup>7</sup> Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

<sup>8</sup>Termi në gjuhën angleze “*reverse discrimination*”.

<sup>9</sup> Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fabián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

*nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.”*

Bazuar në nenin 5, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në nenin 11 “*Veprime pozitive*”, të LMD parashikohet se: “*Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.*”

*E drejta që pretendohet se është cenuar.*

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e parashikuar në nenin 57 të kushtetutës, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim pavarësisht nga raca dhe vendbanimi i personit. E drejta për arsim, formulohet nga neni 57 i Kushtetutës sipas kësaj përmbajtje: “*1. Kushdo ka të drejtën për arsimim. 2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj. 3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë. 4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie. 5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas. 6. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit. 7. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj”.*

E drejta për arsim garantohet në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t’u zbatuar, të tilla si: Konventa e UNESCO Kundër Diskriminimit në Arsim; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Social dhe Kulturore, garanton të drejtën për arsim në nenet 13 e 14; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave garanton në nenin 10, barazinë në arsim midis vajzave dhe djemve në të gjitha nivelet e arsimit si në fshat ashtu edhe në qytet; Protokollin shtesë i Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, në nenin 2, sanksionon se askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsim.

Neni 13, i Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore, sanksionon:

*“1. Shtetet palë të këtij Pakti, njohin të drejtën e secilit për arsim. Ato pajtohen se arsimi duhet të orientohet drejt zhvillimit të plotë të personalitetit njerëzor dhe të ndjenjes së dinjitetit të tij dhe të forcojë respektin për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ato pastaj pajtohen se arsimi duhet t’i mundësojë secilit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë, të ndihmojë*

*mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjitha kombeve dhe të gjitha grupeve racore, etnike ose fetare dhe zhvillimin e veprimtarive të Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.*

*2. Shtetet palë të këtij Pakti pranojnë se për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte:*

*(a) Arsimi fillor duhet të jetë i detyrueshëm dhe falas për të gjithë.*

*(b) Arsimi i mesëm, në format e tij të ndryshme, duke përfshirë arsimin e mesëm teknik dhe profesional, duhet të jetë i përgjithshëm dhe i hapur për të gjithë me të gjitha mjetet e përshtatshme sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimi falas;*

*(c) Arsimi i lartë duhet të bëhet i hapur për të gjithë në mënyrë të barabartë sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme e sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimi falas;*

*(ç) Arsimi themelor duhet të inkurajohet ose të intensivkohet, mundësisht sa më shumë, për ata persona të cilët nuk kanë pasur ose nuk kanë përfunduar plotësisht tërë periudhën e arsimit të tyre fillor;*

*(d) Duhet të vazhdohet aktivisht zhvillimi i një rrjeti shkollor në të gjitha shkallët, të vendoset një sistem i përshtatshëm bursash dhe të përmirësohen vazhdimisht kushtet materiale të personelit mësimor.....*”

*Sipas Komentit të Përgjithshëm Nr.13 (1999), të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, mbi të drejtën për arsim, i cili është autoriteti i ngarkuar me interpretimin e dispozitave të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, arsimi, në të gjitha format e tij dhe në të gjitha nivelet, duhet të ketë karakteristikat si vijon, të cilat janë thelbësore dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën: disponueshmëria, mundësia e përdorimit/ aksesit, pranueshmëria, përshtatshmëria. Në kuadër të aksesit ekonomik, arsimi duhet të jetë i përbalueshëm për të gjithë. Ky dimension i aksesit i nënshtrohet formulimit të ndryshëm, në lidhje me arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Kështu, ndërsa arsimi fillor duhet të jetë i disponueshëm "falas për të gjithë", shtetet duhet të marrin hapa konkretë që të realizojnë në mënyrë progresive arsimin e mesëm dhe të lartë falas. Po sipas Komentit të Përgjithshëm Nr.13 (1999) "Vendosja progresive e arsimit falas", sipas nenit 13, 2, "c", të Paktit, do të thotë se, ndërkohë që shtetet duhet t'i japin përparësi ofrimit të arsimit fillor falas, ato gjithashtu kanë detyrimin të ndërmarrin hapa konkretë drejt arritjes së arsimit të mesëm dhe të lartë falas.*

*Në kuadër të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë në të drejtën për arsim, në Komentin e Përgjithshëm nr.13 (1999), Komiteti shprehet se: "31. Ndalimi i diskriminimit i parashikuar në nenin 2 (2) të Paktit nuk i nënshtrohet as realizimit progresiv dhe as disponueshmërisë së burimeve; ai zbatohet plotësisht dhe menjëherë në të gjitha aspektet e arsimit dhe përfshin të gjitha shkaqet e diskriminimit të ndaluara ndërkombëtarisht. 32. Miratimi i masave të veçanta të përkohshme që synojnë të sjellin barazi de facto për burrat dhe gratë dhe për grupet e pafavorizuara nuk është shkelje e së drejtës për mosdiskriminim në lidhje me arsimin, për sa kohë që masa të tilla nuk çojnë në mbajtjen e standardeve të pabarabarta ose të ndara për grupe të ndryshme dhe me kusht që të mos vazhdojnë pasi të jenë arritur objektivat për të cilat janë marrë. ....37. Shtetet palë duhet të monitorojnë nga afër arsimin - duke përfshirë të gjitha politikat, institucionet, programet, modelet e shpenzimeve dhe praktikatat e tjera përkatëse - në mënyrë që të*

*identifikojnë dhe të marrin masa për të korrigjuar çdo diskriminim de facto. Të dhënat arsimore duhet të ndahen sipas bazave të ndaluara të diskriminimit.”*

Në nenin 17, të LMD, ku sanksionohet ndalimi i diskriminimit në fushën e arsimit, sanksionohet se: “4. Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim përshpejtimin e barazisë në arsim, nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen e përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe këto masa ndërpriten kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.”

Neni 18, i LMD, ngarkon Këshillin e Ministrave dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet e arsimit dhe shkencës, me detyrimin për të marrë masa me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsim. Konkretisht në këtë dispozitë përcaktohet se: “ 1. Këshilli i Ministrave dhe Ministri Përgjegjës për arsimin dhe shkencën janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. 2. Këshilli i Ministrave dhe Ministri përgjegjës për arsimin dhe shkencën, ndër të tjera, marrin secili masa për: ..... c) arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuara, si dhe personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; .....”

*Zbatimi i kuadrit dhe standarteve të mësipërme ligjore, në rastin objekt shqyrtimi.*

- Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës”, si pasojë e mospërfshirjes së studentëve egjiptianë dhe studentëve romë, si kategori përfituese e bursës, sipas VKM nr.903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar.

Në rastin objekt shqyrtimi, pretendimi i ankueses për diskriminim në të drejtën për arsim, ka të bëjë me arsimin e lartë dhe rregullohet nga ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr.80/2015). Sipas nenit 4, pika 2, të ligjit nr.80/2015, shteti garanton të drejtën për të ndjekur arsimin e lartë për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë financiare për t’i përballuar ato. Bazuar në pikën 4, të nenit 4, të ligjit nr.80/2015, Këshilli i Ministrave është autorizuar që të nxjerrë akte nënligjore për përcaktimin e kategorive të individëve që përfitojnë nga kjo e drejtë, sipas pikës 2 të këtij neni. Bazuar në këtë dispozitë ligjore Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr.269/29.03.2017, i cili ka si qëllim mbështetjen financiare të kategorive të caktuara të studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, nëpërmjet përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve me rezultate të larta dhe studentëve që u përkasin shtresave sociale në nevojë.

Sipas pikës 1, shkronjës “c”, të VKM nr.269/2017, të ndryshuar, studentët, të cilët u përkasin shtresave sociale në nevojë, janë si vijon: i) studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike; ii) bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë; iii) studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar; iv) studentët, të cilët kanë, të paktën, njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar; v) studentët, të cilët i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton; vi) studentët, të cilët janë të tretët e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë; vii) studentët, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç; viii) studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç; ix) studentët, të cilët janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç; x) studentët, të cilët janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës; xi) studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit; xii) studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

Sa më sipër rezulton se, studentët romë dhe egjiptianë, të cilët identifikohen përmes vetëdeklarimit, janë parashikuar si kategori e veçantë që përfitojnë nga përjashtimi nga tarifa vjetore të shkollimit, pavarësisht plotësimit të kriterit të notës mesatare apo pamundësisë ekonomike. Ankuesja, ka përfituar nga përjashtimi i tarifës vjetore të shkollimit, sipas VKM nr.269/2017, si studente që i përket komunitetit egjiptian.

VKM nr.903, datë 21.12.2016 “*Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë*”, i ndryshuar (në vijim VKM nr.903/2016, i ndryshuar), që pretendohet nga ankuesja se është diskriminues për shkak të racës pasi nuk parashikon si kategori përfituese të bursave nga fondi i mbështetjes studentore, studentët egjiptianë dhe studentët romë, ka dalë në bazë të nenit 112, të ligjit nr.80/2015 si dhe të një sërë ligjesh të posaçme që trajtojnë disa prej kategori që konsiderohen sipas këtij akti si studentë që i përkasin shtresave në nevojë. Konstatohet se, jo të gjitha kategoritë që konsiderohen si studentë që vijnë nga shtresat sociale në nevojë, janë subjekte që trajtohen me ligj të posaçëm.

Referuar, nenit 6, pika 3, të ligjit nr.80/2015, “*bursa*” është financimi monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një studenti, mbi bazën e arritjeve akademike të tij ose kriterëve të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Bazuar në nenin 110 dhe 112, shteti mbështet studentët me bursa, nëpërmjet grantit të mësimdhënies. Sipas nenit 112, të ligjit nr.80/2015, granti i mësimdhënies përfshin, fondin për institucionet publike të arsimit të lartë dhe fondin e mbështetjes

studentore. Në pikat 3, 4, 5 dhe 6, të nenit 112, të ligjit nr.80/2015, parashikohet: “3. Fondi i mbështetjes studentore përfshin tri kategori financimi: a) bursat e studimit për studentët e shkëlqyer; b) bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar; c) bursat e studimit për studentët që i përkasin shtresave sociale në nevojë. 4. Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale në hyrje, në rang vendi, pavarësisht programit të studimit dhe institucionit, në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Studenti vazhdon të përfitojë nga ky grant nëse rezultatet e tij, gjatë gjithë viteve të studimit, vazhdojnë të jenë të shkëlqyera. 5. Bursat e studimit për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit në institucione publike të arsimit të lartë, që përbëjnë prioritet kombëtar, u shpërndahen studentëve që studiojnë në fushat e përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave. 6. Bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë u shpërndahen studentëve që janë shpallur fitues në institucionet publike të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret për t’u konsideruar si studentë në nevojë, të përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Bazuar në autorizimin ligjor të dhënë nga neni 112, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM Nr.903/21.12.2016, i ndryshuar, i cili ka si qëllim përcaktimin e kriterëve për kategoritë e studentëve që do të përfitojnë bursë nga fondi i mbështetjes studentore. Synimi i masave të përcaktuara në VKM nr.903/2016, të ndryshuar është të mbështesë me bursë studentët me rezultate të larta, studentët, të cilët kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në institucionet publike të arsimit të lartë si dhe studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë. Sipas pikës 5, të VKM nr.903/2016, të ndryshuar, kategoritë e studentëve që konsiderohen në nevojë dhe që përfitojnë bursë, janë të njëjta me kategoritë e studentëve të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, sipas VKM nr.269/2017, të ndryshuar, me përjashtim të kategorisë së studentëve romë dhe studentëve egjiptianë, të cilët nuk përfshihen si kategori e studentëve nga shtresa sociale në nevojë dhe rrjedhimisht nuk përcaktohen si kategori e studentëve që përfitojnë bursë.

Kur parashtron një ankesë për diskriminim, para së gjithash, pala ankuese duhet të tregojë se është trajtuar ndryshe nga një person tjetër ose grup personash të vendosur në një situatë të njëjtë ose të ngjashme, ose se është trajtuar në mënyrë të barabartë me një grup personash të vendosur në një situatë të ndryshme. Personi ose grupi tjetër i personave me të cilët krahasohet pala ankuese quhet "krahasuesi" dhe se ky i fundit nuk duhet që ta mbartë shkakun e mbrojtur që ka pala ankuese.

Komisioneri, së pari do të shqyrtojë nëse pala ankuese mund të konsiderohet se është në një situatë të ngjashme ose të ngjashme me grupin me të cilin ajo krahasohet. Rezulton se, ankuesja e cila vetëdeklaroi se i përkët pakicës kombëtare egjiptiane, pretendon se trajtohet ndryshe dhe në mënyrë më pak të favorshme, për shkak se studentët egjiptianë nuk përfshihen si kategori përfituese të bursave sipas VKM nr.903/2016, të ndryshuar, duke bërë krahasimin me faktin se VKM nr.269/2017, e ndryshuar përfshin kategorinë e studentëve romë dhe egjiptinë si kategori përfituese.

Së pari, Komisioneri konstaton se, skema e mbështetjes për studentët nëpërmjet përjashtimit nga tarifat vjetore të shkollimit sipas VKM nr.269/2017, të ndryshuar, është objektivisht e ndryshme nga

skema e mbështetjes nëpërmjet bursave studentore, që ofrohet nëpërmjet VKM nr.903/2016, të ndryshuar. E para, eliminon pengesat për shtresat në nevojë për të aksesuar arsimin e lartë duke eliminuar tarifatat administrative, ndërsa e dyta është një formë tjetër mbështetje e cila cila synon të mbështesë studentët nga kategoritë në nevojë në vijim të studimeve. Komisioneri vlerëson se, zbatimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit nuk mund të zbatohet në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte, por gjen zbatim brenda të njëjtës kategori ose lloj të drejte apo përfitimi. Përfundimisht situatat e gjeneruara nga parashikimet e dy akteve të Këshillit të Ministrave, konkretisht VKM nr.269/2017, i ndryshuar dhe VKM nr.903/2016, i ndryshuar, nuk mund të konsiderohen se janë të njëjta ose të ngjashme. Krahasimi nëse trajtimi është diferencuar dhe më pak i favorshëm, për shkakun e pretenduar të diskriminimit, mund të bëhet vetëm brenda të njëjtës skemë dhe jo të krahasohen dy skemat e ndryshme.

*Së dyti*, ankuesja nuk ngre pretendime se ndodhet në situatë të njëjtë ose të ngjashme me ndonjë prej kategorive përfituese sipas VKM nr.903/2016, e ndryshuar dhe për shkak të shkakut të mbartur prej saj, është vendosur në kushte më pak të favorshme duke mos u përfshirë si kategori përfituese e bursave. Ankuesja pretendon se, meqënëse studentët që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane përfshihen si kategori përfituese sipas VKM nr.269/2017, të ndryshuar dhe përjashtohen nga tarifatat vjetore të shkollimit ata janë përjashtuar pa asnjë arsye si kategori përfituese sipas VKM nr.903/2016, të ndryshuar, duke mos patur mundësi të përfitojnë bursat që jepen sipas këtij akti. Komisioneri vlerëson se, edhe në këtë kontekst, krahasimi i bërë nga pala ankuese, nuk është i bazuar, pasi “krahasuesi”, nuk duhet që ta mbartë shkakun e mbrojtur.

*Së treti*, ligji nr.80/2015, nuk jep ndonjë përcaktim se kush do të konsiderohet student në nevojë, por e ka lënë përcaktimin e këtyre kategorive në vlerësimin e Këshillit të Ministrave. Në referim të nenit 5, të ligjit nr.80/2015, shteti, nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij, ka përgjegjësitë dhe detyrimet që të vendosë në dispozicion fonde publike për të garantuar aksesin në arsimin e lartë, sipas meritës, pavarësisht nga mundësitë financiare të individëve. Në lidhje me kriterin ekonomik, VKM-ja nr.903/2016, e ndryshuar, referon tek legjislacioni i posaçëm për asistencën sociale, duke përcaktuar si kategori përfituese, studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, ndërsa parashikohen në mënyrë të shprehur disa kategori të tjera studentësh të cilët kryesisht kanë parashikime dhe rregullime me ligje të posaçme, të cilat gjithashtu kanë shërbyer si bazë ligjore për miratimin e VKM.

Nga shqyrtimi i ankesës rezultoi se, ankuesja ka arritur të përfitojë trajtimin me bursë sipas VKM nr.903/2016, të ndryshuar, pasi nëna e saj trajtohet me ndihmë ekonomike, sipas legjislacionit të posaçëm për asistencën sociale. Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja J.Gnuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë detyrimin dhe përgjegjësitë e shtetit për të vënë në dispozicion fonde publike për të garantuar aksesin në arsimin e lartë, sipas meritës, pavarësisht nga mundësitë financiare të individëve, Komisioneri thekson se, vendosja e një sistemi

të përshtatshëm bursash, përbën një nga mjetet për të siguruar realizimin e plotë dhe në baza të barabarta për të gjithë të të drejtës për arsim.

Në rastin objekt shqyrtimit të dhënat e administruara tregojnë se, familja e ankueses nuk ka arritur të identifikohet dhe të trajtohet me ndihmë ekonomike që në momentin e parë dhe ankuesja ka filluar të trajtohet me bursë si studente në nevojë sipas parashikimeve të VKM nr.903/2016, i ndryshuar jo që prej fillimit të vitit akademik, por në një moment të mëvonshëm, konkretisht nga muaji janar 2023. Këto të dhëna nxjerrin në dukje faktin se, ka kategori familjesh të cilat pavarësisht se nuk përfshihen në kategoritë përfituese të ndihmës ekonomike, për shkak të të ardhura të ulta dhe të pamjaftueshme për të siguruar vetë të drejtat dhe nevojat bazë, apo për shkak se vijnë nga grupe të disavantazuara apo që prej kohësh kanë vuajtur nga diskriminimi, janë të ekspozuara ndaj rrezikut për të mbetur jashtë skemës së ndihmës ekonomike, skemë e cila përfaqëson kriterin e vetëm ekonomik të vendosur nga VKM-ja për të përfituar bursë. Studentët e tjerë në nevojë që përfitojnë bursë janë kategori të cilat janë të parashikuara në mënyrë specifike dhe nuk janë të kushtëzuar nga kriteri i gjendjes ekonomike.

Heqja e tarifës vjetore të shkollimit është një masë pozitive që mundëson aksesin në arsimin e lartë për kategori të studentëve, të cilët për shkaqe të cilat nuk janë në kontrollin e tyre, nuk mund t'a aksesojnë atë. Megjithatë, heqja e kësaj pengese administrative, sikurse është tarifa vjetore e shkollimit, nuk ofron mundësi reale për kategori të disavantazuara studentësh që t'a përfundojnë arsimin e lartë, kostot për ndjekjen e të cilit janë të konsiderueshme për personat që janë në pamundësi ekonomike.

Është një fakt i pranuar se, përjashtimi dhe diskriminimi i romëve dhe egjiptianëve ka ekzistuar ndër vite. Prej vitesh, janë miratuar një sërë aktesh, të cilat synojnë të sigurojnë barazi, përfshirje dhe integrim të pakicave romë dhe egjiptiane, nëpërmjet angazhimeve për marrjen e masave për kapërcimin e kësaj situate. Në këtë kontekst, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin Nr.701, datë 18.11.2021 "*Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025*". Plani i Veprimit, pranon se, niveli i arsimimit të popullsisë romë, dhe në një masë më të vogël egjiptiane është shumë më i ulët se i banorëve të tjerë në vend. Lidhur me studimet e arsimit të lartë, të dhënat janë shumë të kufizuara. Sistemi ROMALB ka mungesë në databazë. Sipas raportit të Komisionit Europian të 2019-ës, hendeku në përfundimin e arsimit terciar u rrit në mënyrë të konsiderueshme në Shqipëri, pasi shkalla e romëve që përfunduan arsimin terciar mbeti rreth 1% si në 2011 ashtu edhe në 2017<sup>10</sup>.

Nëpërmjet Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025, qeveria është angazhuar që të rrisë aksesin e barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore (Qëllimi i Politikës 4). Për zbatimin e këtij angazhimi, ndër të tjera në Planin e Veprimit parashikohet se: "*Gjithashtu incentivat si bursat apo kuotat e veçanta për të rinjtë romë dhe egjiptianë janë shumë të*

---

<sup>10</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025.



*rëndësishme për një tranzicion efektiv të kalimit të tyre në të gjitha nivelet arimore. Prandaj plani ka përfshirë masa që mbështesin studentëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë dhe të lartë nëpërmjet ofrimit të bursave, reduktimit të tarifës së shkollimit dhe përjashtimit nga tarifa e pagesës për mbrojtjen e gjuhës së huaj, detyruese për pajisjen me diplomë dhe gjithashtu sigurimin e kuotave të veçanta”.*

Në kuadër të Qëllimit të Politikës 4, rezultatet e pritshme të kësaj politike janë : “i. Deri në fund të 2025, 80% me shumë fëmijë romë dhe egjiptianë përfundojnë arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë n137 krahasim me vitin 2020”, ndërsa një ndër treguesit që ka të bëjë me arsimin e lartë parashikohet : “4.9.1. Studentët romë dhe egjiptianë që marrin bursë. Baseline 1 (2020): 0, Target 5 (2025): 33% më shumë mbi vlerën baseline”. Në kuadër të masave dhe aktiviteteve të parashikuara është parashikuar: “1.9 Mbështetje e studentëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e lartë nëpërmjet ofrimit të bursave, reduktimit të tarifës së shkollimit dhe përjashtimit nga tarifa e pagesës për mbrojtjen e gjuhës së huaj, detyruese për pajisjen me diplomë.”, ndërsa produkti i synuar nga kjo masë është : “43% më shumë studentë romë dhe egjiptianë të ciklit të parë (bachelor) dhe ciklit të dytë (Master) përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore të shkollimit, përcaktuar mbi vlerën baseline të 2020-ës...”

Dimensionin gjinor, përbën një nga parimet themelore që udhëheq Planin e Veprimit, i cili pranon faktin se gratë romë dhe egjiptiane kanë më tepër gjasa të vuajnë përjashtimin dhe diskriminimin gjinor.

Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve, në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian (Deklarata e Poznanit) 2019, përbën një tjetër angazhim të marrë nga vendi ynë për të garantuar barazi dhe integrim për pakicat romë dhe egjiptiane. Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj deklarate, vendi ka bërë një angazhim për të vazhduar dhe rritur përpjekjet për barazi të plotë dhe integrimin e romëve, veçanërisht përmes zbatimit dhe ndjekjes së Konkluzioneve të Përbashkëta të Seminareve Rome, në sektorët e Punësimit, Strehimit, Arsimit, Shëndetit, Regjistrimit civil, Mbrojtje Sociale dhe Mosdiskriminim. Vendi është angazhuar për të zhvilluar, miratuar dhe zbatuar standarde rajonale mbi buxhetimin publik në lidhje me integrimin e romëve për politikën e synuar, si dhe rritjen e buxhetit publik (qëndror dhe lokal) për integrimin e këtij komuniteti; të krijojë kanale dhe mekanizma zyrtarë për përfshirjen e përbashkët të vetëqeverisjes vendore dhe komunitetit romë në formulimin e politikave, vendimmarrjes, zbatimit dhe monitorimit të përpjekjeve të ndërmarra për arritjen e objektivave të kësaj Deklarate<sup>11</sup>.

E drejta për arsimim, si të gjitha të drejtat e njeriut, imponon tre lloje ose nivele detyrimesh për shtetet palë: detyrimet për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur. Nga ana tjetër, detyrimi për të përmbushur përfshin njëkohësisht, një detyrim për të lehtësuar dhe një detyrim për të ofruar. Si rregull i përgjithshëm, shtetet palë janë të detyruara të përmbushin (sigurojnë) një të drejtë kur një

<sup>11</sup> . Regional Cooperation Council. Declaration Of Western Balkans Partners On Roma Integration Within The Eu Enlargement Process. 5 July 2019, Poznan. <https://www.rcc.int/docs/464/orhan-usein-while-one-out-of-four-young-people-in-the-region-is-inlimbo-this-is-true-for-three-out-of-four-roma>

individ ose grup nuk është në gjendje, për arsye jashtë kontrollit të tyre, ta realizojë vetë të drejtën me mjetet që disponon.

Të dhënat e pakta në dispozicion në lidhje me arsimin e lartë të pakicës rome dhe pakicës egjiptiane tregojnë se, përfshirja e studentëve romë dhe egjiptianë në arsimin e lartë vazhdon të mbetet e ulët. Kriteri ekonomik për të përfituar bursë mundet që jo gjithomë të jetë efektiv për këto pakica, të cilat kanë qenë të diskriminuara ndër vite, efekte të cilat ende vazhdojnë të jenë prezent. Në kontekstin e të drejtës për arsimim të anëtarëve të grupeve që kanë vuajtur diskriminimi, efektet e të cilit vazhdojnë, kërkojnë zbatimin e masave pozitive specifike për këto grupe. Kriteri ekonomik i lidhur me përfitimin e ndihmës ekonomike për pakicat rome dhe egjiptiane, të cilat kanë jo vetëm vështirësi ekonomike, por situata e tyre bashkëshoqërohet edhe me faktorë të tjerë që janë të lidhur ngushtësisht me këto pakica. Fëmijët romë dhe egjiptianë ndeshin vështirësi edhe si pasojë e nivelit arsimor të prindërve të tyre të cilët nuk e shikojnë arsimin si parësi. Një numër i madh nxënësish romë braktisin arsimin e detyruar jo vetëm si rezultat i qëndrimeve diskriminuese, mungesës së mbështjetjes dhe ngacmimeve në shkollë, por edhe për shkak të nevojës për të ndihmuar prindërit e tyre në aktivitete që gjenerojnë të ardhura. Duke konsideruar këto barriera shumica e prindërve romë që përballen me përjashtimin social besojnë se vajza e tyre do të jetë më e mbrojtur nëse e braktis shkollën në vitet e para të adoleshencës dhe të përgatitet për të krijuar familjen e saj, sesa të mbetet pas me mësim, të trajtohet me inferioritet nga bashkëmoshatarët e saj jo-romë e mbi të gjitha të nisë një sjellje jo të hijshme<sup>12</sup>.

Marrja e veprimeve pozitive, është e nevojshme për të siguruar “barazinë substanciale” që do të thotë gëzim i barabartë i mundësive për të patur akses në të mirat që gjenden në shoqëri, dhe jo thjesht “barazi formale”<sup>13</sup>. Nëse nuk konsiderohet përshtatshmëria e marrjes së masave të veçanta, shtohet rreziku që praktikrat dhe rregullat të diskriminojnë personat apo grupet e personave në mënyrë të tërthortë (diskriminim i tërthortë).

Kuptimin dhe fushën e veprimit të masave të veçanta në Konventën për Eleminimin e Diskriminimit Racial, në të cilën Shqipëria ka aderuar në vitin 1994, e ka sqaruar imtësisht Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit Racial (CERD) në Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 32<sup>14</sup>. Sipas CERD, koncepti i masave të veçanta ose veprimeve pozitive bazohet në parimin se ligjet, politikat dhe praktikrat e miratuara dhe të zbatuara në mënyrë që të përmbushin detyrimet sipas Konventës kundër Diskriminimit Racor, kërkojnë që të merren masa shtesë sipas rrethanave, përmes adoptimit të masave të veçanta të hartuara për t’i siguruar grupeve të paavantazuara gëzimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

---

<sup>12</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025.

<sup>13</sup> [http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf)

<sup>14</sup> CERD, General Recommendation Nr. 32 “the meaning and scope of special measures in the International Convention on the Elimination of Racial Discrimination” Sesioni 75, gusht 2009, [file:///C:/Users/User/Downloads/CERD\\_C\\_GC\\_32-EN.pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/CERD_C_GC_32-EN.pdf)

Detyrimi për të marrë masa të veçanta ose veprime pozitive dallohet nga detyrimi i përgjithshëm pozitiv i shteteve që të sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore pa diskriminim për personat dhe grupet nën juridiksionin e tyre. Masat e veçanta nuk duhen ngatërruar me të drejtat specifike për disa kategori personash apo komunitesh, si për shembull të drejtat e personave që i përkasin pakicave për të gëzuar kulturën e tyre, për të ushtruar besimin fetar dhe përdorur gjuhën e tyre apo të drejtat e grave për trajtim të barabartë me burrat. Këto të drejta janë të drejta të përhershme të njohura si të tilla nga instrumentat ndërkombëtare. Ndaj duhet bërë dallimi ndërmjet masave të veçanta apo veprimeve pozitive dhe detyrimeve për të respektuar të drejtat e njeriut të përhershme si në ligj edhe në praktikë<sup>15</sup>.

Veprimet pozitive duhet të jenë të përshtatshme për situatën e cila duhet ndrequr. Ato duhet të jenë legjitime në një shoqëri demokratike, të respektojnë parimet e drejtësisë dhe proporcionalitetit dhe të jenë të përkohshme. Masat duhet të hartohen dhe zbatohen sipas nevojave, të bazohen në vlerësime realiste të situatës së individëve dhe komuniteteve përkatëse. Vlerësimet për nevojën e masave të veçanta duhet të kryhen në bazë të të dhënave të sakta të detajuara në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes apo origjinës etnike ose kombëtare dhe duke përfshirë një perspektivë gjinore, mbi statusin social-ekonomik dhe kulturor dhe kushtet e grupeve të ndryshme në popullatë dhe pjesëmarrjen e tyre në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Këto masa duhet të hartohen dhe zbatohen me konsultim paraprak me komunitetet e prekura dhe pjesëmarrjen e tyre aktive<sup>16</sup>.

Neni 1, paragrafi 4, i Konventës kundër Diskriminimit Racor parashikon se: *“masat e veçanta të marra me të vetmin qëllim që të sigurojnë përparimin e disa grupeve raciale apo etnike ose individëve që e kërkojnë këtë mbrojtje sipas nevojës, në mënyrë që të gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore, nuk do të konsiderohet diskriminim racor, me kusht që këto masa të mos çojnë në mbajtjen e të drejtave të veçuara për grupe të ndryshme racore dhe se ato nuk do të vazhdojnë, pasi të jenë arritur objektivat për të cilat ato ishin marrë”*. Një formulim të ngjashëm e përmban edhe LMD. Frazja *“nuk do të konsiderohen si diskriminim racor”* qartëson faktin se ato nuk përbëjnë diskriminim.

Veprimet pozitive nuk janë një përjashtim nga parimi i mos-diskriminimit, por janë pjesë integrale e kuptimit dhe janë thelbësore për eliminimin e diskriminimit racor dhe përparimin e dinjitetit njerëzor dhe barazisë efektive<sup>17</sup>.

Nocioni i *“përparimit të përshtatshëm”* do të thotë programe të drejtuara nga qëllime që kanë si objektiv heqjen dhe rregullimin e mospërputhjeve në gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat prekin grupe dhe individë të veçantë, duke i mbrojtur ata nga diskriminimi. Këto mospërputhje përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në mospërputhjet e vazhdueshme apo strukturore dhe pabarazitë *de facto* që rezultojnë nga rrethanat e historisë, të cilat vazhdojnë t'i mohojnë grupeve dhe individëve vulnerabël përparësitë thelbësore për zhvillimin e plotë të

<sup>15</sup> CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32, para 15

<sup>16</sup> CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32, para 16-18.

<sup>17</sup> CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32, para 10-20

personalitetit njerëzor. Nuk ka nevojë që të provohet diskriminimi historik për të bërë të vlefshëm një program veprimesh pozitive; theksi duhet vënë në korigjimin e mospërputhjeve të tashme dhe parandalimin e krijimit të ç'ekuilibrave të tjerë<sup>18</sup>.

Direktivat e BE-së për mosdiskriminimin shprehimisht parashikojnë mundësinë e marrjes së veprimeve pozitive duke parashikuar se, me qëllim arritjen e barazisë së plotë në praktikë, parimi i trajtimit të barabartë nuk pengon ndonjë shtet anëtar që të mbajë apo miratojë masa të veçanta për të parandaluar apo kompensuar dizavantazhet që lidhen me një shkak të mbrojtur<sup>19</sup>.

Masat e posaçme lejojnë kalimin përtej qasjes individuale dhe marrjen në konsideratë të aspektit kolektiv të diskriminimit<sup>20</sup>.

Trajtimi i diskriminimit nga këndvështrimi i një shkakut të vetëm dështon për të kapur ose trajtuar në mënyrën e duhur manifestimet e ndryshme të trajtimit të pabarabartë me të cilat njerëzit mund të përballen në jetën e tyre të përditshme. Asnjë grup i karakterizuar nga një shkak specifik nuk është homogjen. Çdo person ka një model unik karakteristikash, të cilat kanë ndikim në marrëdhëniet e tyre me njerëzit e tjerë dhe mund të përfshijnë dominimin e disave mbi të tjerët<sup>21</sup>.

LMD, në nenin 3, pika 3 dhe 5, rregullon situatat e shfaqjes së diskriminimit si pasojë e veprimit/ ndërveprimit të më shumë se një shkakut, duke parashikuar shprehimisht : “3. *“Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit. .... 5. “Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas.”*

Në të drejtën ndërkombëtare, ndërsektorialiteti njihet zyrtarisht nga Komiteti CEDAW, si një koncept për të kuptuar qëllimin e detyrimit të shteteve palë për të eliminuar diskriminimin. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), në pjesën hyrëse, të nenit 2, parashikon: “Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtashme dhe pa vonesë, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave...”. Në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga parashikimet e nenit 2, të

<sup>18</sup> CERD, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 32, para 22

<sup>19</sup> Direktiva e Këshillit 2000/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”, Neni 5; Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”, Neni 7; Direktiva e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime”, neni 6; Direktiva e Parlamentit Europian dhe e Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”, e rishikuar.

<sup>20</sup> [http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf)

<sup>21</sup> [http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf)

Konventës CEDAW, në Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 28 (2010) mbi detyrimet thelbësore të shteteve palë, sipas nenit 2 të Konventës, Komiteti CEDAW, sqaron se: *“Ndërsektorialiteti është një koncept bazë për të kuptuar shtrirjen e detyrimeve të përgjithshme të shteteve palë të përfshira në nenin 2. Diskriminimi i grave në bazë të seksit dhe gjinisë është i lidhur pazgjidhshmërisht me faktorë të tjerë që prekin gratë, si raca, përkatësia etnike, feja ose besimi, shëndeti, statusi, mosha, klasa, kasta dhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Diskriminimi në bazë të seksit ose gjinisë mund të prekë gratë që i përkasin grupeve të tilla në një shkallë të ndryshme ose në mënyra të ndryshme nga burrat.”*

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial, në Rekomandimin e Përgjithshëm nr.25 (2000) mbi dimensionet gjinore të diskriminimit racor, vëren se *“diskriminimi racor nuk prek gjithmonë gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë ose në të njëjtën mënyrë. Ka rrethana në të cilat diskriminimi racor prek vetëm ose kryesisht gratë, ose prek gratë në një mënyrë të ndryshme, ose në një shkallë të ndryshme nga burrat. Një diskriminim i tillë racor shpesh do t'i shpëtojë zbulimit nëse nuk ka njohje ose njohje të qartë të përvojave të ndryshme të jetës së grave dhe burrave, si në fusha të jetës publike ashtu edhe private.”*

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 16 (2005) *“E drejta e barabartë e burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 3 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore)”* evidenton se: *“Grave shpesh u mohohet gëzimi i barabartë i të drejtave të tyre njerëzore, veçanërisht për shkak të statusit më të vogël që u është caktuar atyre nga tradita dhe zakonet, ose si rezultat i diskriminimit të hapur ose të fshehtë. Shumë gra përjetojnë forma të ndryshme diskriminimi për shkak të ndërthurjes së seksit me faktorë të tillë si, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike dhe të tjera, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose statusi tjetër, si mosha, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, gjendja martesore, statusi i refugjatit ose migrantit, duke rezultuar në disavantazh kompleks.”*

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të LMD, Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues. Bazuar në këtë kompetencë ligjore, legjislacionin, standartet dhe parimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mosdiskriminimit dhe barazisë, Komisioneri rekomandon si më poshtë:

Duke mbajtur në konsideratë faktin se, ligji nr. 80/2015, *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”* e ka lënë në diskrecionin e Këshillit të Ministrave për të caktuar se cilët do të konsiderohen studentë në nevojë që mund të përfitojnë bursë; faktin që ky ligj, ka autorizuar Këshillin e Ministrave që të nxjerrë akte nënligjore për të përcaktuar kategoritë e studentëve në nevojë që kanë të drejtë të përfitojnë bursë; me qëllimin për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin, si dhe për të siguruar *“barazinë substanciale”*, Komisioneri rekomandon Këshillin e Ministrave që të marrë masa për të rishikuar VKM Nr.903, datë 21.12.2016 *“Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes*

*studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”*, i ndryshuar, me qëllim konsiderimin e përfshirjes në këtë akt të masave të përshtatshme pozitive në lidhje me studentët romë dhe egjiptianë, dhe studentët familjet e të cilëve pavarësisht se nuk përfitojnë nga ndihma ekonomike në kuadër të asistencës sociale për shkak të pamundësisë ekonomike e kanë të pamundur për shkaqe që nuk janë në kontrollin e tyre që të realizojnë të drejtën për arsim të lartë. Në çdo rast, masat e parashikuara për të luftuar diskriminimin racor, por jo vetëm, duhet të marrin në konsideratë dimensionin gjinor. Parandalimi dhe trajtimi i diskriminimit duhet të mbajë gjithmonë në konsideratë ndërsektorialitetin dhe veprimin e më shumë se një shkak.

**- Në lidhje me pretendimin e ankueses se është diskriminuar për shkak të vendbanimit.**

Në ankesën e paraqitur ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të vendbanimit, pasi për shkak të pamundësisë ekonomike në të cilën ndodhet familja e saj dhe distancës së vendbanimit nga universiteti që ajo ndjek, e ka të pamundur që të përballojë shpenzimet e transportit për ndjekjen e universitetit. Ankuesja pretendon se, për nxënësit që ndjekin shkollën e mesme dhe që jetojnë 5 km larg nga shkolla ofrohet mbështetje, por një gjë e tillë nuk zbatohet edhe për shkollën e lartë.

Rezulton se, ankuesja është banore në fshatin Mollas, Njësia Administrative Drenovë, Bashkia Korçë dhe ndjek studimet e larta pranë Universitetit Fan S. Noli, Korçë, i cili ndodhet në qytetin e Korçës dhe pretendohet nga ankuesja se është në një distancë mbi 5 km me vendbanimin e përhershëm të saj. Në këtë mënyrë, ankuesja nuk mund të ecë në këmbë për të ndjekur procesin mësimor, por i duhet që këtë distancë ta përshkojë nëpërmjet mjeteve të transportit. Në këtë kontekst, ankuesja pretendon se trajtohet në mënyrë më pak të favorshme për shkak të vendbanimit, pasi për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm ofrohet mbështetje për ata nxënës që jetojnë në një distancë mbi 5 km nga institucioni arsimor që ata ndjekin.

Rezulton se, për studentët që ndjekin arsimin e lartë në institucionet e arsimit të lartë (IAL) 5 km larg vendbanimit të përhershëm, nuk ofrohet ndonjë mbështetje bazuar në kritere që lidhen me vendbanimin.

Bazuar në pretendimet e parashtruara nga ankuesja, rezulton në fakt se, krahasimi që bëhet prej saj ka si bazë të njëjtë vendbanimin, pra faktin që nxënësit dhe studentët banojnë në një distancë prej më shumë se 5 km nga institucioni ku ndjekin arsimin, dhe se ndryshimi konsiston në faktin se, mbështetja ofrohet për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar dhe nuk ofrohet për studentët të cilët ndjekin arsimin e lartë.

Komisioneri, së pari do të shqyrtojë nëse pala ankuese mund të konsiderohet se është në një situatë të ngjashme ose të ngjashme me grupin me të cilin ajo krahasohet, pra me nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar dhe që banojnë në një distancë prej më shumë se 5 km nga institucioni arsimor ku ndjekimin procesi. Përpara se Komisioneri të bëjë këtë vlerësim, ka identifikuar aktet

nëpërmjet të cilave ofrohet mbështetja për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar në institucione 5 km nga vendbanimi i tyre. Rezulton se, sipas vendimit nr.666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konviktet dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, dalë në zbatim të nenit 19, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se, një ndër kategoritë që përfitojnë mbështetje janë edhe nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre dhe nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9- vjeçare brenda rrezes prej 5 km, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas parashikimeve të këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike. Synimi i këtij parashikimi është mbështetja e nxënësve në pamundësi ekonomike që ndjekin procesin mësimor 5 km nga vendbanimi i tyre i përhershëm. Në këtë mënyrë, që një nxënës të përfitojë mbështetjen sipas VKM-së përkatëse, duhet që njëkohësisht të plotësojë kriterin e ekonomik si dhe atë të vendbanimit.

Një tjetër akt që ofron mbështetje për nxënësit që ndjekin arsimin parashkollor në një institucion arsimor 5 km larg vendbanimit të tyre, është VKM nr.682, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar. Sipas këtij akti përballohen nga fondet publike të shpenzimeve transporti për kategoritë e mëposhtme:

- nxënësve që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg institucioneve arsimore publike më të afërta (shkollë/kopsht); Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë institucionet arsimore publike (shkollë/kopsht);
- nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në institucionet arsimore publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);
- nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik;
- nxënësve që ndjekin procesin mësimor në institucionet arsimore publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, godinat e të cilave kanë dalë jashtë funksionit apo janë në rikonstruksion/rindërtim, vërtetuar me aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe që udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor, larg vendbanimit të përhershëm.

Sipas ligjit nr.80/2015, studentët në bazë të meritës kanë të drejtën të zgjedhin institucionin e arsimit të lartë ku duan të ndjekin studimet, duke u kushtëzuar nga kriteret e pranimit në programet përkatëse pavarësisht nga vendbanimi i tyre, ndërsa regjistrimet në arsimin

parauniversitar kryhen bazuar në vendbanimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit.

Në kuadër të aksesit ekonomik, arsimit duhet të jetë i përballueshëm për të gjithë. Kushtetuta, në mënyrë të shprehur sanksionon në nenin 57, pikat 4 dhe 5, se, arsimit i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie, ndërsa arsimit i detyrueshëm dhe arsimit i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas. Ky dimension i aksesit i është nënshtruar një formulimi të diferencuar kushtetues, në lidhje me nivelet e ndryshme të arsimit. Kështu, ndërsa Kushtetuta sanksionon në mënyrë të shprehur se, arsimit i detyrueshëm (fillor dhe ai i mesëm i ulët) dhe arsimit i mesëm duhet të jetë *falas*, nuk e përmban një parashikim të shprehur në mënyrë të drejtëpërdrejtë për arsimin e lartë. Një formulim të diferencuar midis niveleve të ndryshme të arsimit sanksionohet edhe nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Sipas këtij Pakti, ndërsa arsimit fillor duhet të jetë i disponueshëm, falas për të gjithë, shtetet duhet të marrin hapa konkretë që të realizojnë në mënyrë progresive arsimin e mesëm dhe të lartë falas. “*Vendosja progresive e arsimit falas*”, sipas Paktit, do të thotë se, ndërkohë që shtetet duhet t'i japin përparësi ofrimit të arsimit fillor falas, ato gjithashtu kanë detyrimin të ndërmarrin hapa konkretë drejt arritjes së arsimit të mesëm dhe të lartë falas.

Nëpërmjet VKM-ve të sipërcituara që gjejnë zbatim në fushën e arsimit parauniversitar, shteti ka ndërmarrë hapa që synojnë të garantojnë aksesueshmërinë e arsimit nga pikëpamja ekonomike dhe eliminimin e pengesave ekonomike, që mund të rezultojnë për disa kategori të nxënësve për shkak të vendbanimit dhe gjendjes së tyre ekonomike, duke i dhënë përparësi arsimit bazë (arsimit fillor dhe i mesëm i ulët). Mbështetja e nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm të lartë dhe atë profesional mundësohet, kur godinat në të cilat nxënësit që ndjekin procesin mësimor në institucionet arsimore publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, kanë dalë jashtë funksionit apo janë në rikonstruksion/rindërtim dhe ata janë të detyruar që të udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor, larg vendbanimit të përhershëm.

Komisioneri vlerëson se, në rastin e arsimit të lartë, shteti ka një hapësirë më të madhe veprimi, për të vlerësuar dhe realizuar brenda mundësive të disponueshme, në mënyrën më të përshtatme dhe në mënyrë progressive, të drejtën për arsim. Aktualisht, nuk zbatohet asnjë skemë e mbështetjes për studentët që ndjekin një IAL në distancë mbi 5 km nga vendbanimi i tyre i përhershëm, për të vlerësuar nëse ka ndonjë diferencë në trajtim midis ndonjë kategori ose grupi të veçantë.

Për sa më sipër, duke mbajtur parasysh ndryshimet mes sistemit arsimor parauniversitar dhe arsimit të lartë, nuk mund të bëhet paralelizëm në lidhje me formën e mbështetjes financiare nga shteti për nxënësit dhe studentët, në lidhje me largësinë e vendbanimit të tyre nga institucioni arsimor ku ata ndjekin procesin mësimor. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, studentët të cilët janë të detyruar të udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor larg vendbanimit të tyre të përhershëm, nuk janë në kushte të njëjta ose të ngjashme me kategorinë e nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar, në të gjitha nivelet e tij.



Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja J.G nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë për shkak të vendbanimit, si pasojë e mosfrimit të mbështetjes financiare për studentët të cilët janë të detyruar të udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor larg vendbanimit të tyre të përhershëm. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Këshillit të Ministrave.

Në lidhje me subjektin tjetër kundër të cilit është paraqitur ankesa, Universiteti “Fan S.Noli” Korçë, Komisioneri konstaton se, ky institucion është i ngarkuar vetëm me zbatimin e parashikimeve që bëhen në VKM objekt shqyrtimi dhe nga ana tjetër nuk ka kompetencë ligjore që të miratojë apo ndryshojë akte të cilat ofrojnë mbështetje financiare për kategoritë e studentëve në nevojë apo studentët të cilët janë të detyruar të udhëtojnë mbi 5 km larg vendbanimit të tyre të përhershëm për të ndjekur procesin mësimor.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses J.G, për shkak të racës dhe vendbanimit, nga ana e Këshillit të Ministrave dhe Universitetit “Fan S. Noli” Korçë.
2. Komisioneri rekomandon Këshillin e Ministrave që të rishikojë Vendimin Nr.903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, me qëllim konsiderimin e përfshirjes në këtë vendim të masave pozitive në lidhje me studentët romë dhe egjiptianë, dhe studentët familjet e të cilëve pavarësisht se nuk përfitojnë nga ndihma ekonomike në kuadër të asistencës sociale, për shkak të pamundësisë ekonomike nuk mund të realizojnë të drejtën për arsim të lartë. Në çdo rast, masat e parashikuara për të luftuar diskriminimin racor, por jo vetëm, duhet të marrin në konsideratë dimensionin gjinor. Masat e parashikuara për të parandaluar, trajtuar dhe luftuar diskriminimin, duhet të mbajë gjithmonë në konsideratë ndërsektorialitetin dhe veprimin e më shumë se një shkak.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Raca, vendbanimi  
Fusha: Arsim  
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim/Rekomandim